# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-432382**
VERSIONI

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Telefonata njëorëshe Trump-Putin, Kremlini: Bisedë konstruktive, Rusia nuk ka plane agresive ndaj Europës |
| ADRESA | `https://www.gazetatema.net/bota/telefonata-njeoreshe-trump-putin-kremlini-bisede-konstruktive-rusia-nuk-ka--i584871` |
| BURIMI | gazetatema.net |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 9 shtator 2026, 06:52:09 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 9 shtator 2026, 07:35:00 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `84a05e812456c46985bcd5b1234cde2d4fda8181c7566089d23ac43b9dac687c` |
| TEKSTI | `f1905582b32f51f98415260dafa8c101bb197e8b2b62f81b663845927c946d0e` |
| PAMJA | `5968efe0045fe49adb4f83eb691226757346f067dcc5c6b7c4d66c09a15f6cdc` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `ea65240e8d40bfec9bcc3c0aed99db5aa1724d9277e7af1010d1556d0c3e7cd5` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | – |
| ANKORIMI | nuk është ankoruar ende<br>*Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/ea65240e8d40bfec9bcc3c0aed99db5aa1724d9277e7af1010d1556d0c3e7cd5`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored · dritarja 1280×1024 px

# Telefonata njëorëshe Trump-Putin, Kremlini: Bisedë konstruktive, Rusia nuk ka plane agresive ndaj Europës

9 Shtator 2026, 09:35Bota TEMA

Telefonata njëorëshe Trump-Putin, Kremlini: Bisedë konstruktive,

Ndërsa vendet që mbështesin Kievin po shtojnë ndihmat e tyre ushtarake, Moska flet për një afrim të mundshëm me SHBA-në pas një bisede telefonike mes Putinit dhe Trumpit.

Presidenti rus Putini i garantoi Trumpit se Rusia nuk ka "plane agresive" ndaj Evropës, deklaroi këshilltari i tij për politikën e jashtme, Juri Ushakov, para gazetarëve. Kjo deklaratë vjen vetëm pak javë pas sulmit hibrid ndaj aeroportit Leipzig-Halle, për të cilin qeveria gjermane fajëson Rusinë.

Kremlini: Biseda Putin-Trump ishte "konstruktive"
Juri Ushakov, këshilltari i presidentit rus Vladimir Putin për çështjet e politikës së jashtme, tha se biseda telefonike njëorëshe mes Putinit dhe Donald Trumpit ishte "konstruktive dhe mjaft e sinqertë".

Sipas Ushakovit kreu i Kremlinit i paraqiti gjithashtu Trumpit një "analizë objektive dhe të detajuar të zhvillimeve në fushën e betejës". Putini i shpjegoi Trumpit edhe se "çfarë mund të bëjnë amerikanët për t'u dhënë fund sa më shpejt luftimeve". Hollësi të mëtejshme këshilltari rus nuk dha.
Ushakov tha se Moska e vlerëson pozitivisht vizitën e të dërguarve specialë amerikanë, Steve Witkoff dhe Jared Kushner, të cilët zhvilluan bisedime ndërmjetësuese në Rusi fundjavën e kaluar. Megjithatë pas kësaj vizite nuk u njoftuan përparime të rëndësishme.

Sipas Ushakovit, presidenti amerikan ka lënë të kuptohet se, nëse lufta përfundon, marrëdhëniet mes Rusisë dhe Shteteve të Bashkuara mund të rikthehen plotësisht si më parë. Gjatë bisedës u diskutua edhe për shkëmbime të tjera të të burgosurve.

Zelenski: Ide me vlerë nga të dërguarit amerikanë

Presidenti ukrainas Volodymyr Zelenski deklaroi ndërkohë se të dërguarit amerikanë që vizituan Kiyvin paraqitën disa ide "shumë të mira dhe me vlerë" për t'i dhënë fund luftës katër e gjysmë vjeçare të Rusisë. Ai shtoi se shpreson të takohet me Trumpin brenda dy javëve të ardhshme.

Nga ana tjetër zëdhënësi i Kremlinit, Dmitry Peskov, tha se Rusia mbetet e vendosur të arrijë objektivat e saj ushtarake dhe beson se është pranë fitores. Megjithatë vëzhgues ukrainas dhe perëndimorë vlerësojnë se Moska nuk ka arritur të bëjë ndonjë përparim të rëndësishëm në vijën e frontit. Deri tani presidenti amerikan Trump nuk ka bërë asnjë deklaratë publike lidhur me këtë telefonatë./DW

---

## Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

POSTOJE KOMENTIN

[Kaos në aeroportet britanike, mbi 600 fluturime anulohen pas defektit në sistemin e kontrollit ajror]

08:15 Bota

[SHBA ndalon një sërë produktesh kanadeze]

08:05 Bota

[Trump distancohet nga Netanyahu për Bregun Perëndimor, SHBA nuk pengon sanksionet ndaj vendbanimeve izraelite në zonën e pushtuar]

07:53 Bota

[Gjermania do të dërgojë urgjentisht raketa interceptuese “Patriot” në Ukrainë: Duhet mburojë ajrore kundër sulmeve ruse]

07:46 Bota / 1 koment

[Po mbulonin ngjarjen e vullkanit në Indonezi, zhduken 5 gazetarë]

23:00 Bota

[Itali/ 157 kg kokainë të fshehura në kamionin me kuaj, droga vlente deri në 14 milionë euro! Shpërndahej edhe nga trafikantët shqiptarë]

22:40 Bota

[Gjykata amerikane: Kushtetuta federale nuk garanton të drejtën për ujë të pastër]

22:20 Bota / 3 komente

[Trump: Irani është ndëshkuar rëndë nga bllokada amerikane]

20:50 Bota / 8 komente

[Shpërthen “lufta” Izrael-Britani e Madhe, mbyllet Ambasada e Londrës në Jeruzalem pas sanksioneve ndaj Tel Avivit]

20:30 Bota / 6 komente

[Shefi i NATO-s u kërkon aleatëve të rrisin mbështetjen për Ukrainën: Vonesat kushtojnë jetë]

20:10 Bota / 2 komente

**Më të lexuarat**

**24 oret e fundit**

**Javen e fundit**

**Berisha vijon turin në SHBA, mbështetësi nga Teksasi: U b...**

14:15 Politika / 50 komente

**Përplasja mes biznesmenëve për pronën në Palasë, Filip Ça...**

10:10 Sociale / 26 komente

**FOTO: Marjana Koçeku iu bashkohet deputetëve të Sali Beri...**

17:35 Politika / 104 komente

**Nga Banka e Shqipërisë tek Parlamenti Evropian, punësimet...**

14:50 Politika / 10 komente

**Incidenti me disa protestuese, reagon Iris Luarasi: Do e ...**

19:40 Politika / 104 komente

## Blog Tema

**"Respekte", z. Korrupsion!**

22:30 Blog / 6 komente

**Përse dështoi Reforma në Drejtësi**

17:10 Blog / 36 komente

**Pelegrinazhi amerikan i Berishës i duhet vetëm Berishës**

16:24 Blog

## Lajme ekskluzive!

Nëse doni të jeni i pari për t'u informuar mbi lajme ekskluzive, regjistrohuni më poshtë.

Numri juaj i telefonit REGJISTROHU
Ju mund të ç'regjistroheni në çdo moment.

Powered by Tomorrow.io

TemA është një gazetë e përditshme e palidhur politikisht e botuar në Tiranë, Shqipëri në gjuhën shqipe. E themeluar në korrik 1999, TemA është një nga gazetat ditore më të vjetra në Shqipëri dhe aktualisht shet rreth 15,000 kopje ditore në mbarë vendin.

Built and Monetized by

- Politika
- Kronika
- Editorial
- Blog
- Bota
- Sport
- Shëndeti
- Turizëm
- Sociale
- Ekonomia
- Antena
- Rajoni
- Kulturë
- Lifestyle
- Dossier
- Hi-Tech

- Kontakt
- Te dhënat personale
- Cookies

Built and Monetized by

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.